



## Brif mujor mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore - janar 2017 -

### I GJYQËSORI

#### 1. Pavarësia

##### Këshilli Gjyqësor

Këshilli Gjyqësor në janar i mbajti seancën 243<sup>1</sup> dhe 244<sup>2</sup>. Janë miratuar më tepër aktvendime dhe vendime për zgjedhjen e gjykatësve porotë, mbarim të funksioneve dhe udhëzime të përkohshme. Është botuar edhe shpallje për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Themelore Gjevgjeli. Në seancën e 243 janë marrë vendime për kërkesat e dorëzuara për rivlerësim të punës së gjykatësve – kandidatë për kryetarë për vitin 2015 dhe 2016.

Në seancën e 244 është marrë Vendimi me të cilin ushtrues i detyrës – kryetari i Gjykatës Themelore Gjevgjeli u caktua Zllata Popova, gjykatëse në Gjykatën Themelore Gjevgjeli. Janë përcaktuar edhe referuesit nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për kërkesat e dorëzuara për përcaktim të mosprofesionalizmit dhe kryerjes së papërgjegjshme të funksionit gjyqësor nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktim të Përgjegjësisë së Gjykatësve. Janë marrë vendimet për ankesat e gjykatësve kundër vendimeve për rendin e punës për vitin 2017.

#### Gjykata Administrative – Kërkesat e refuzuara për mbrojtje të të drejtave të ish-kryetares së Gjykatës së Lartë

Gjatë dhjetorit të vitit 2016 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë mori Vendimin DOV. nr. 0249/1 për vlerësimin inordinar të Lidija Nedellkovës si kryetare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë. Vlerësimi është kryer në seancë jopublike dhe ka qenë për periudhën nga 01.01.2015 deri më 30.09.2016, kurse kryetarja është vlerësuar me shumë mirë me 185 pikë të marra.

E pakënaqur nga vendimi, znj. Lidija Nedellkova, i ka dorëzuar Këshillit Gjyqësor kërkesë për rivlerësim. Këshilli në janar të vitit 2017 ka marrë vendim të ri DOV. nr. 02-1/5 me të cilin e ka refuzuar kërkesën si të pabazë. Pas këtij vendimi ish-kryetarja e Gjykatës së Lartë ka dorëzuar Kërkesë për mbrojtje të të drejtës, anulim të vendimit të Këshillit Gjyqësor dhe masë të përkohshme – ndalim për ndërmarrje të mëtejshme të veprimeve të Këshillit Gjyqësor për zgjedhje të kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në kërkesë shkruhet se gjatë vlerësimit inordinar është shkelur parimi i transparencës së procedurës si parimi themelor i drejtësisë së procedurës që përbën veprim të paligjshëm të kryer nga Këshilli Gjyqësor me të cilin janë ndaluar apo kufizuar të drejtat dhe liritë e garantuar kushtetuese, të nenit 8 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (në Republikën e Maqedonisë liri është gjithçka që nuk është ndaluar me Kushtetutë dhe ligj).

<sup>1</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=486>

<sup>2</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=489>



Sipas Gjykatës Administrative, veprimi me të cili ndalohen apo kufizohen ato të drejta, duhet të jetë i paligjshëm, që do të thotë se veprimi të jetë i kundërligjshëm dhe i individualizuar d.m.th. duhet t'i drejtohet një personi të përcaktuar saktë, ndërsa jo një subjekti juridik siç është Këshilli Gjyqësor. Vlerësimi inordinar i Këshillit Gjyqësor ka qenë në suazat e nenit 9 paragrafit 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor i cili ka kompetencë të kryejë vlerësim inordinar gjatë zgjedhjes së gjykatësit në gjykatën më të lartë apo të zgjedhjes së kryetarit të gjykatës. Këshilli procedurën për vlerësim inordinar e ka zbatuar për të gjithë kandidatët e paraqitur për kryetar të Gjykatës së Lartë dhe vendimin e ka marrë në përputhje me nenin 38 paragrafi 4 të Rregullores së Këshillit Gjyqësor sipas të cilit “vlerësimi kryhet në seancë jopublike në bazë të raportit të Komisionit”.<sup>3</sup> Për këto arsye, znj. Nedellkova nuk i janë shkelur të drejtat të cilave u është drejtuar ajo. Ajo ka mundësi të dërgojë ankesë te Gjykata e Lartë.

### **Administrata Gjyqësore – Sindikata e punëtorëve të administratës, organeve gjyqësore dhe shoqatave të qytetarëve në RM (AOGjSh)**

Pasi Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka marrë vendim për rivendosjen e Zhivko Mitrevskit për kryetar të Bashkimit të Sindikatave të Maqedonisë (BSM), mëngjesin e 06.01.2017 në hapësirat e BSM-së Mitrevski së bashku me 40 persona, sipas AOGjSh-së, kanë bërë invadim,<sup>4</sup> i kanë nxjerrë jashtë me forcë të punësuarit, ndërsa me kryetarin e atëhershëm me funksion ushtrues detyre Darko Dimovski janë ballafaquar edhe fizikisht, pas kësaj Dimovski ka përfunduar në traumatologji me nevojë për ndihmë mjekësore. Nga AOGjSh-ja pohojnë<sup>5</sup> se z. Mitrevski si i preferuari i pushtetit është kthyer në mënyrë joligjore në funksionin e kryetarit të BSM-së, se është mbështetur nga tre kryetarë jolegjitimë të sindikatave degë. Nga AOGjSh-ja thonë se pikërisht Mitrevski mban edhe përgjegjësinë për mossundimin e të drejtës në Gjykatën Administrative dhe Prokurorinë Publike sepse e ka “privatizuar” BSM-në.

Konfederata Evropiane e Sindikatave (ETUC) dhe tri bashkimet evropiane – Federata Evropiane e Sindikatave të Sektorit Publik (EPSU), Federata Evropiane e Sindikatave të Sektorit Industrial (Industri All Evropa) dhe Federata Evropiane e Bujqësisë dhe Sektorit të Ushqimit (EFFAT) shprehën shqetësim të madh mbi konfliktin midis kryesisë së BSM-së dhe katër sindikatave të saj anëtare – Agro Sindikata, SHTEKBMSHM, SIEM dhe AOGjSh. Këto institucione ndërkombëtare e ofruan ndihmën e vet për mbajtjen e takimeve të përbashkëta me kryesinë e BSM-së dhe sindikatave anëtare.<sup>6</sup>

## **2. Transparenca**

### **Këshilli për Vërtetim të Fakteve**

<sup>3</sup> Vendimet e Gjykatës Administrative USPI. nr. 5/2017 dhe USPI. nr. 6/2017 gjenden në këto vegëza: <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20263> dhe <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20264>

<sup>4</sup> [http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=424:2017-01-06-13-18-38&catid=1:latest-news](http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=424:2017-01-06-13-18-38&catid=1:latest-news)

<sup>5</sup> [http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=425:2017-01-11-09-38-21&catid=1:latest-news](http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=425:2017-01-11-09-38-21&catid=1:latest-news)

<sup>6</sup> [http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=427:2017-01-13-13-11-22&catid=1:latest-news](http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=427:2017-01-13-13-11-22&catid=1:latest-news)



Këshilli për Vërtetim të Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktim të Përgjegjësisë së Gjykatësit vazhdon të punojë në mënyrë jotransparente, nuk boton shpallje për seancat e veta publike dhe nuk ka ende një ueb-faqe të vetin.

### 3. Paanësia

#### PSP – Vazhdon bashkëpunimi i vështirësuar me Gjykatën Themelore Shkup 1 – Shkup

PSP-ja ka reaguar përsëri se vazhdon bashkëpunimi i vështirësuar me Gjykatën Themelore Shkup 1.<sup>7</sup> PSP-ja prej një kohe të gjatë flet se Gjykata po e pengon punën e prokurorisë që në veprimet e para të cilat i ndërmori formimi i kësaj prokurorie me Marrëveshjen e Përzhinos. Ky lajmërim vjen pasi prokuroria i ka dorëzuar disa kërkesa për lëshim të urdhrit për kontroll gjykatësit dezhurn të Njësisë për krim të organizuar dhe korrupsion në këtë Gjykata. Këto kërkesa lidhen me më tepër procedura parahetimore dhe hetimore të cilat i mban PSP-ja dhe si shtesë të kërkesave janë dorëzuar dëshmi dhe bisedat e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve në bazë të të cilave prokuroria ka kompetencë dhe kërkon lëshim të urdhrave për kontroll. Pas dorëzimit të kërkesave gjykatësi dezhurn është zëvendësuar kurse kërkesat u janë shpërndarë gjykatësve të tjerë. Nga gjykata është shqiptuar vetëm një urdhër për kontroll dhe kjo më 25.01.2016, kështu që nga PSP-ja është kryer kontroll në një lokacion në Shkup, për nevojat e procedurës hetimore në lëndën me titullin e punës “Titanik”.

Të gjitha kërkesat e tjera për dhënien e urdhrit për kontroll që lidheshin me ish-funksionarë të lartë dhe funksionarë të tanishëm janë refuzuar. PSP-ja thekson se gjykatësit për procedurën paraprake, të cilëve u janë dhënë lëndët, Elena Josifoviq dhe Aleksandra Pop Stefaniya, kanë shprehur mospërputhje mbi kërkesat, kurse këshillat penale të përbërë nga gjykatësit Lubinka Basheska, Goran Boshevski dhe Vlladimir Pançevski, gjykatësit Vlladimir Pançevski, Lenka Davitkovska dhe Diana Gruevska Ilievska dhe gjykatësit Lenka Davitkovska, Diana Gruevska Ilievska dhe Ivica Stefanovski i pranuan mospërputhjet e shprehura të gjykatësve mbi procedurën paraprake.

#### PSP – Tërhiqet padia e lëndës “Puç”

Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të cilat dalin dhe lidhen me ndjekjen joligjore të komunikimeve e ka tërhequr propozimin për akuzën e lëndës “Puç”, ku janë akuzuar pesë persona.<sup>8</sup> Kjo lëndë, në të cilën i akuzuari i katërt ishte lideri i opozitës Zoran Zaev, i është dorëzuar PSP-së nga Prokuroria Publike e RM-së. Zaev është akuzuar për veprën e dhunës ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore. Sipas PSP-së, gjendja faktike e vendosur në propozimin e akuzës është në kundërshtim me dëshmitë të cilat i posedojnë dhe me gjetjet në procedurat hetimore “Target” dhe “Kështjella”. Sipas PSP-së, marrja e vendimit të tillë është kryer me qëllim që të mblidhen dëshmi shtesë

<sup>7</sup><http://www.jonsk.mk/2017/01/31/%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%BB%D0%B6%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D0%B5%D0%B6%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%BA%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D0%BE/>

<sup>8</sup><http://www.jonsk.mk/2017/01/18/%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%BB%D0%B5%D1%87%D0%B5%D0%BD%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B2%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BC%D0%B5%D1%82%D0%BE%D1%82/>





që do ta qartësojnë në tërësi gjendjen faktike dhe do të mundësojnë marrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm nga prokuroria publike.

## Kompetenca

### Gjykata Kushtetuese – anulohet neni 144 i Ligjit për Shërbimin Gjyqësor

Me iniciativë të Sindikatës së AOGjSh-së dhe procedurës së ngritur paraprake për vlerësim të kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit për Shërbimin Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi nenin 144 të këtij Ligji, i cili i obligonte nëpunësit gjyqësorë të dorëzojnë certifikata për njohjen e gjuhëve të huaja dhe programeve kompjuterike.<sup>9</sup> Sipas Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi marrëdhënien e punës që tashmë është vendosur e determinon me kushte të reja të cilat janë në lartësinë e përgjithësimit pa marrë parasysh se në kohën kur i punësuari ka lidhur marrëdhënie pune ato kushte nuk janë marrë parasysh.

### Ministria e Drejtësisë – funksionon ueb-faqja e re e Byrosë për Përfaqësim të RM-së para GjEDNj-së

Nga Ministria e Drejtësisë informojnë<sup>10</sup> se Byroja për Përfaqësim të Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) e ka vënë në funksion ueb-faqen e re <http://biroescp.gov.mk>, ku gjenden të gjitha informacionet relevante në lidhje me kompetencat e Byrosë si dhe të gjitha informacionet mbi punën e Gjykatës Evropiane.

## PROCEDURAT MË TË RËNDËSISHME GJYQËSORE

### “Kështjella”

Më datë 17.01.2017 është mbajtur seanca për lëndën K-1905/16. Gjykata vazhdoi procesin me seancën përgatitore, p.sh. një seancë dëgjimore për shqyrtimin e provave në një procedurë përmbledhëse, dhe në kundërshtim me ligjin, e obligoi dhe PSP-në të kërkojë na KQZ-ja deklasifikim të të dhënave përkatësisht të dëshmimeve të propozuara. Nga PSP-ja theksuan se nuk kanë siguruar akt për përdorim të informacioneve të klasifikuara të cilat me pas ti propozojnë si dëshmi në këtë procedurë. Prokurorja publike e PSP-së, Lençe Ristoska, duke dhënë edhe një ekzemplar nga komunikimi i realizuar me MPB-në dhe DSK-në si prodhuese të informacioneve, theksoi se PSP-ja ka vepruar në përputhje me obligimin e gjykatës dhe u është drejtuar organeve të lartpërmendura. Në përgjigjet e kërkesave të deklasifikimit, nga MPB-ja është kërkuar saktësim i mëtejshëm, kurse nga DSK-ja është thënë se deklasifikimi i të dhënave do të kishte pasoja mbi sigurinë e shtetit dhe se ato janë me rëndësi të veçantë për punët operative të DSK-së. Gjykatësja, Lidija Petrovska e obligoi PSP-në që edhe njëherë t'i drejtohet DSK-së, sepse, siç theksoi, përgjigjet e marra për kërkesat për deklasifikim të informacioneve nuk kanë qenë përfundimtare. Seanca e ardhshme gjyqësore është vendosur më 13.03.2017

<sup>9</sup> [http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=428:-144-&catid=1:latest-news](http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=428:-144-&catid=1:latest-news)

<sup>10</sup> [http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1357](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1357)



### “E majta”

Më 18.01. 2017 është mbajtur gjykimi për lëndën K-986/16 ku të akuzuar janë anëtarët e partisë politike “E majta” – Zdravko Saveski dhe Vlladimir Kunovski, demok për pjesëmarrjen në shkatërrimin e zyrës popullore të Presidentit Gjorgje Ivanov më 13 prill 2016 gjatë protestave. Gjykimi është shtyrë për më 07.04.2017 për shkak se gjykatësja është me raport mjekësor.

### “Zoran Bozhinovski”

Më 23.01.2017 ishte vendosur gjykimi për lëndën KOK-79/16, ku si i akuzuar për veprat penale “Shoqërim kriminal” dhe “Spiunim” është gazetari Zoran Bozhinovski. Gjykimi është shtyrë përsëri, por këtë herë për shkak të dorëzimit të parregullt, pas të cilit gjykata kërkoi nga shërbimet kompetente të MPB-së ta gjejnë dëshmitarin, t’ia dorëzojnë ftesën dhe ta shoqërojnë me roje në seancën e ardhshme gjyqësore, të vendosur më 22.02.2017.

### “Lagjja e Trimave”

Debati për lëndën KOK. nr. 127/15, e njohur në publik si “Lagjja e Trimave” ku të akuzuarit gjykohen për veprat penale “Terrorizëm” dhe “Organizatë terroriste” janë të mbyllura për opinionin. Lënda lidhet me luftimin e armatosur në Kumanovë – aksion policor për shkatërrimin e grupit të armatosur terrorist në periudhën nga 9 deri më 10 maj 2015 në Kumanovë. Nga forcat maqedonase të sigurimit e humbën jetën tetë përfaqësues të policisë, kurse janë plagosur 37 policë të tjerë. Nga të dyshuarit për terrorizëm janë gjetur 14 trupa pa jetë me uniforma.

### “Rover”

Gjykimi për lëndën “Rover” K 2454/15 ku i akuzuari i katërt është Lube Boshkovski, kryetari i partisë politike “Të Bashkuar për Maqedoninë” dhe ish-ministri i punëve të brendshme, është shtyrë përsëri. Arsyeja ishte mungesa e të akuzuarit Goce Mitrevski për shkak të sëmundjes. Kjo është hera e tretë që gjykimi për “Rover” fillon nga fillimi sepse Gjykata e Apelit Shkup e ka anuluar dy herë aktvendimin e shkallës së parë për shkak të një sërë lëshimesh dhe gjendjes së papërcaktuar faktike. Ish-ministri i punëve të brendshme Lube Boshkovski është akuzuar për ndihmë në vrasje në vitin 2001.

## II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

### PSP – Hapen dy procedura të reja hetimore me titull pune “Tarifa” dhe “Tank”

Prokuroria Publike Speciale hapi dy procedura të reja hetimore “Tank” dhe “Tarifa”. Lënda e parë lidhet me furnizimin me Mercedesin zyrtar me vlerë prej pothuajse 600 mijë eurosh. Ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale, keqpërdorim i pozitës zyrtare.<sup>11</sup> Dy persona që ta plotësojnë dëshirën e ish-kryeministrit, Nikolla Gruevskit, sipas PSP-së e kanë favorizuar firmën e cila duhet ta kryejë furnizimin.

<sup>11</sup> <http://www.jonsk.mk/2017/01/24/%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%B4%D0%B2%D0%B5-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8-%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D0%B6%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BF%D0%BA%D0%B8-%D0%BF/>



Në kundërshtim me neni 36 të Ligjit për Furnizime Publike, në specifikimin e tenderit ka pasur kushte të cilat kanë favorizuar një subjekt të caktuar ekonomik. Rasti me furnizimin me automjet të shtrenjtë shkaktoi reagime të stuhishme në publik, pasi është zbuluar në “bombat” e opozitës, ku dëgjohej se si ish-kryeministri dhe ish-ministrja e punëve të brendshme merren vesh për furnizimin me automjetin jashtëzakonisht të shtrenjtë marka “Mercedes” nëpërmjet MPB-së, kurse për nevojat e ish-kryeministrit.

Rasti i dytë është me emrin e koduar “Tarifa” dhe lidhet me furnizimin me softuer për ELEM. Me dyshim se shtatë persona e kanë keqpërdorur autorizimin zyrtar. Kanë mundësuar që firma e cila e ka fituar tenderin të kualifikohet në fazën e dytë të negociatave pa dokumentacion të tërësishëm. Vlera e tenderit është mbi 4 milionë euro. Sistemi duhej të zbatohet tërësisht deri në vitin 2013, kurse dëshmitë e PSP-së tregojnë se një pjesë e rëndësishme e softuerit nuk është implementuar edhe pse deri më tani janë paguar 3,7 milionë euro. Shtatë të dyshuarit me moszbatimin e softuerit kanë shkaktuar dëm prej 450 mijë eurosh.

### Lënda “Erazmus”

Gjykimi për rastin “Erazmus” është mbajtur më 30.01.2017. Në këtë lëndë janë akuzuar shtatë profesorë të Fakultetit Ekonomik në Shkup për veprat penale “Marrje mito”, “Marrje shpërbllim për ndikim të kundërligjshëm”, “Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare” dhe “Dhënie mito”. Seanca gjyqësore është shtyrë, pasi në seancë, një pjesë e avokatëve të të akuzuarve kërkuan përjashtim të gjykatëses Lubica Basheska dhe gjykatësit Ivica Stefanovski, si anëtarë të këshillit gjyqësor. Gjykimi është shtyrë për një kohë të pacaktuar, derisa të vendoset mbi kërkesën për përjashtim të gjykatësve.

### Lënda “Mito”

Më 23.01.2017 është vendosur gjykimi me titull pune “Mito” ose KOK 62/16, ku si i akuzuar është Zoran Zaev, kryetar i partisë politike LSDM, për veprën penale “Marrje mito”. Gjykimi është shtyrë me kërkesë për përjashtim të prokurorit publik. Seanca gjyqësore kryesore është shtyrë për më 23.02.2017.

### Komisioni Shtetëror për Ndalim të Korrupsionit

Në seancën publike të mbajtur më 4 janar 2017, Komisioni Shtetëror për Ndalim të Korrupsionit (KShNK) i hodhi poshtë kundërshtimet e dorëzuara nga Koalicioni i Udhëhequr nga Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë – Shkup mbi shkeljen e Kodit Zgjedhor (neni 8-a) lidhur me punësimin dhe ndërtimin e objekteve publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.<sup>12</sup> Sipas vendimeve të marra dhe të shpallura nga KShNK-ja kundërshtimet janë hedhur poshtë sepse shpalljet janë botuar para shpalljes së zgjedhjeve, ose kanë marrë miratim nga KShNK-ja, apo mjetet janë parashikuar në Buxhet për aktivitetet e ndërmarra gjatë fushatës.

### Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë – sa ka bërë Maqedonia për ndalimin e korrupsionit?

Drejtoresha e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, Aneta Arnaudovska i hodhi poshtë kritikën nga një pjesë e opinionit se Maqedonia, ndërsa njëkohësisht edhe Akademia, nuk

<sup>12</sup> Shpallje e KShNK-së nga seanca publike e mbajtur më 4.01.2017

[https://www.dksk.mk/index.php?id=19&tx\\_news\\_pi1%5Bnews%5D=13&tx\\_news\\_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx\\_news\\_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=0162cb710e48ea0a5e2f4d4579ccbbb8](https://www.dksk.mk/index.php?id=19&tx_news_pi1%5Bnews%5D=13&tx_news_pi1%5Bcontroller%5D=News&tx_news_pi1%5Baction%5D=detail&cHash=0162cb710e48ea0a5e2f4d4579ccbbb8)



kanë bërë asgjë për ndalimin e korrupsionit në shoqëri. Ajo ka marrë pjesë në lajmet e TV Nova ku ka folur mbi punën e Akademisë dhe theksoi se pret formim të qeverisë dhe funksionim të Kuvendit që të vazhdojnë reformat në gjyqësor.<sup>13</sup>

### III TË DREJTAT THEMELORE

#### Sundimi i të drejtës

Fokusi kryesor në muajin janar është drejtuar kah dhënies së mandatit për formim të qeverisë pas zgjedhjeve të 11 dhjetorit. Neni 90 i Kushtetutës e shkruan qartë se Presidenti është i obliguar në afat prej 10 ditësh t'ia japë mandatin partisë apo partive të cilat kanë siguruar shumicën e mandateve për deputetë në Kuvend. Edhe pse në atë afat prej 10 ditësh askush nuk arriti të krijojë koalicion me shumicë të mandateve për deputet, Presidenti vendosi që t'ia japë mandatin Nikolla Gruevskit, liderit të koalicioni të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, e cila ka fituar 51 mandate. Edhe pse DPMNE dhe koalicioni ka fituar më shumë mandate për deputetë, ata nuk kanë siguruar shumicën prej minimum 61 deputetësh, kurse megjithatë lideri i partisë ka marrë mandatin për formim të qeverisë. Pas afatit prej 20 ditësh për negociata për shumicën e re parlamentare dhe për dorëzimin e programit dhe formimit të qeverisë së re, DPMNE-ja nuk arriti të sigurojë shumicë. Menjëherë, pas kësaj, Zoran Zaev, lideri i opozitës kërkoi nga Presidenti Ivanov t'ia japë mandatin por kjo gjë nuk ndodhi.

#### Liria e shprehjes dhe mediat

“Figura e mediave për pluralizmin politik në Maqedoni mbetet e njëjtë si para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Pasi përfundoi periudha parazgjedhore prej 100 ditësh, ku kishte rregulla të veçanta për mediat, shumica e televizioneve iu kthyen politikës redaktore të vet.”. Ky është përfundimi i përgjithshëm nga Raporti i monitorimit të demokracisë në Maqedoni – MODEM, që lidhet me përmbajtjet e mediave të emetuara në Shërbimin Radiodifuziv Publik dhe në televizionet komerciale me koncesion kombëtar në periudhën nga 16 deri më 20 dhe nga 23 deri më 27 janar 2017, të zbatuar nga Institutit për Studime Komunikologjike – Shkup.<sup>14</sup>

Në këtë Raport nxirret përfundimi se televizionet 24 Vesti, Telma, Alsat M dhe TV 21 kanë pasur pozitë neutrale dhe kanë observuar në mënyrë kritike, kurse te Sitell, Alfa, TV Nova dhe Kanal 5 dominojnë qëndrimet e partisë politike VMRO DPMNE dhe informacionet për arritjet e funksionarëve të saj. Përrjashtim bën Televizioni i Maqedonisë, i cili në pjesën më të madhe vazhdoi të informimin e paanshëm mbi ngjarjet kryesore politike dhe shoqërore, edhe përkrah përfundimit të mandatit të redaktorit të emëruar nga opozita, në përputhje me Marrëveshjen e Përzhinos.

<sup>13</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/---aae-->

<sup>14</sup> <http://respublica.edu.mk/attach/MODEM-izvestaj-januari-MK-2017.pdf>



## Liria e shoqërimit

### “Revolucioni laraman”

Dy aktivistë qytetarë, përfaqësues të Revolucionit laraman u gjendën përsëri në bankën e të akuzuarit me akuzë se kanë marrë pjesë në turmë e cila ka kryer vepër penale.

- Në lëndën K-1271/16, ku si i akuzuar është aktivisti qytetar – Mariglen Demiri, sipas vlerësimeve të kryera nga ekspertiza, shteti nga Demiri kërkon dëmshpërblim prej 522.000 denarësh, përkatësisht 8.500 eurosh. Ekspertiza është kontestuar nga mbrojtësi me arsyetimin se është e paligjshme, në gjykim ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i Kabinetit të Presidentit të RM-së. Gjykimi është shtyrë për më 14.03.2017.
- Lënda K-1526/16 ku i akuzuar është aktivisti qytetar dhe deputeti Pavle Bogoevski edhe pse është shtyrë tashmë disa herë, si rezultat i përcaktimit, saktësimit dhe vendosjes së shumës për dëmshpërblim, është shtyrë përsëri që të saktësohet edhe më tej kërkesat për dëmshpërblim dhe të saktësohen edhe më tej dëshmitë e dorëzuar shtesë.

## Diskriminimi

Në muret e ShF “Gjorgji Sugarev” Manastir janë vizatuar kryqë naziste dhe janë shkruar grafite “Vdekje evgjitëve” dhe “Vdisni evgjitë”.<sup>15</sup> Grafitet janë vënë re më 19.01.2017. Ato bëjnë thirrje për dhunë ndaj romëve, përkatësisht janë gjuhë urrejtjeje që përfaqëson edhe vepër penale në përputhje me Kodin Penal. Grafitet e tilla janë me të vërtetë shqetësuese nëse merret parasysh fakti se në këtë shkollë shumica e nxënësve janë romë (rreth 80%).

Me shkrimin e tekstit kryerësi i veprës i ka përmbushur shenjat e veprave penale “Shkaktim i urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës në bazë nacionale, fetare dhe në bazë tjetër diskriminuese” të nenit 319 të Kodit Penal të RM-së, “Diskriminim racor dhe tjetër” të nenit 417 të Kodit Penal të RM-së, si dhe “Rrezikim të sigurisë” të nenit 144 të Kodit Penal të RM-së. Kryerësi i veprës penale përveç se shkakton shkelje të dinjitetit të romëve, dëshirë për zhdukjen dhe mosekzistimin e tyre si bashkësi, e kërcënon edhe sigurinë shumicës së personave dhe bën përpjekje për ndezje të dhunës midis bashkësive në shoqëri.

<sup>15</sup> <http://mhc.org.mk/announcements/521#.WJnJrTsrLIU>

